



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 8 nëntor 2011, në mbledhjen e XVII (shtatëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.05.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama, ndërsa mungoi z. Radisav Peroviq.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Reshadija Regjepagiq dhe z. Valdete Bytyqi, Ministria për Komunitete dhe Kthim, z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë Podujevë, z. Nexhat Sekiraqa, Policia kufitare Veriu, z. Bekim Karagjija, OSBE , z. Istvan Torok, LMT – KFOR- Hungarez, z. Shqipe Durguti, Marija Joviq dhe z. Remzije Ibrahim, ICITAP – Departamenti i Drejtësisë, SHBA.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 6 tetor 2011

Ekstrakti u miratua njëzëri.

3. Riatdhesimi dhe integrimi i të kthyerve nga bota e jashtme

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën e hyrjes.

z. Liman Zeqiri, theksoi, çështja për të cilën po debatohet hyn në kuadër të proceseve të integritit të Kosovës në strukturat evropiane dhe euroatlantike dhe në këtë kontekst pas vitit 2008 kur republika e Kosovës u shpall shtet sovran dhe i pavarur, e pranuar nga shtetet më të fuqishme dhe më me ndikim në botë, nuk ka më azil politik e as ekonomik.

Qeveria e Kosovës, në veçanti Ministrja e Ministrisë për Integritet Evropian kanë bërë punë të madhe për arritjen e standardeve për integritet Evropian përkatësisht liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Riadhesimi dhe integrimi i të kthyerve nga bota e jashtme është ngarkesë dhe barrë e madhe për Kosovën ngase zhvillimi ekonomik nuk është në nivel të kënaqshëm, papunësia është e madhe e nga kjo një pjesë e qytetarëve është në gjendje të rënd sociale.

Sipas një marrëveshjeje është paraparë që brenda një viti në Kosovë të riadhesohen 5000 persona, në këtë kontekst problemi më i madh qëndron në atë se ne nuk kemi qendra strehimi, pra në aspektin e strehimit shumë pak mund të ndihmojmë, mirëpo ne për të kthyerit mund të ofrojmë ndihma për rregullimin e dokumentacionit në Shërbimin e gjendjes civile përkatësisht regjistrimin në Libra amzë si dhe ofrimin e ndihmave në arsim dhe shëndetësi.

z. Burhan Blakçori, theksoi, parafolësi e potencoi se Qeveria e Kosovës i ka nënshkruar marrëveshjet me një numër të shteteve për riadhesimin e azilkërkuesve të cilët nuk e kanë rregulluar leje qëndrimin në shtetet përkatëse, jam i vetëdijshëm se kjo çështje është e imponuar nga faktori ndërkombëtar pavarësisht rrethanave ekonomike dhe sociale me të cilat përballet Kosova. Gjithsesi ky proces është në favor të Kosovës mirëpo është barrë mjaftë e rënd për shtetin tonë të ri andaj jam i mendimit se duke u bazuar në rrethanat ekzistuese, Qeveria e Kosovës është dashtë të insistoj në një marrëveshje specifike, marrëveshje e cila do të përcillej me një fond të caktuar në mënyrë që edhe për Qeverinë e Kosovës por edhe për Komuna të jetë më i lehtë integrimi i të kthyerve në të gjitha fushat e jetës.

z. Nebih Behluli, nënvizoi, riadhesimi i të kthyerve nga bota e jashtme është proces i ndërlikuar i cili domosdoshmërisht do duhej të përcillej me politika favorizuese dhe në mungesë të një strategjie dhe plani konkret mund të thuhet se për riadhesimin e të kthyerve nuk janë të përgatitura as Qeveria e Kosovës por as Komuna në nivelin lokal.

Një organizatë e OKB-së, Kosovën e renditë në vendin e tretë në aspektin e migrimit e kjo ndodhë ngase, përveç tjerash, mungojnë politikat dhe masat parandaluese që qytetarët tanë të mos migrojnë në botën e jashtme.

Jam i mendimit se përmes Agjencionit Kosovar të Privatizimit ka mundësi të sigurohen troje dhe të hulumtohen donatorë për ndërtimin e shtëpive për të kthyerit.

Në disa komuna për integrimin e të kthyerve mbi bazën e planeve dhe angazhimeve konkrete është arritur progres e një prej këtyre komunave është ajo e Ferizajt.

z. Liman Zeqiri, theksoi, faktori ndërkombëtar i njeh mjaftë mirë rrethanat ekzistuese në Kosovë ngase prej pas lufte ka qenë dhe ende është i involvuar në sfera të ndryshme, mirëpo sa i përket kriterëve për ndihmë të kthyerve aktualisht një personi i takojnë 1000 €, për familje shuma e ndihmës varet nga numri i anëtarëve të familjes përkatëse ndërsa për zejtar, në formë stimulimi, mund të jepen deri 10.000 €.

E ceka më parë se strehimi mbetet sfida jonë më e madhe ngase këtë çështje e rëndon edhe më tepër lagjja kuvajtiane në të cilën ka 12 vite që në kontejner jetojnë rreth 132 familje në kushte tejet të vështira dhe gjendje të rëndë sociale

Pajtohem se riatdhesimi dhe integrimi i të kthyerve është problem delikat mirëpo duhet të jemi të vetëdijshëm se ky proces është i ngutshëm dhe ne domosdo duhet t'i përmbushim obligimet tona.

z. Nebih Behluli, theksoi, për zgjidhjen e kësaj çështjeje angazhimet duhet të jenë të gjithanshme e unë po e përmendi një fakt se në Komunën e Istogut një biznesmen i ka ndarë 200 troje të urbanizuara, andaj nëse në Komunën tonë sigurohet një numër i caktuar i trojeve më lehtë do të gjendeshin donatorët për ndërtim të shtëpive.

z. Burhan Blakçori, nënvizoi, pajtohem se çështja për të cilën po debatojmë është mjaftë e ndërlikuar dhe kërkon angazhim të të gjitha strukturave në nivel qendror dhe atë lokal, mirëpo sa i përket strehimit unë jam për zgjidhje kolektive e jo individuale.

4. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01/190-06
Podujevë,
8 nëntor 2011**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**